

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **635-26-1285-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Energy A+ SH.P.K.
NUI	811922849
Adresa	Prishtinë, Veternik, Pn
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	+38348530550
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Avdyl Morina
Adresa elektronike	energyaplus@outlook.com
Data e parashtrimit të ankesës	09.04.2026



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës

Njoftimi per Kontrate 13.03.2026

Kerkesa per rishqyrtim 02.04.2026

Pergjigja AK 03.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kemi paraqitur pranë AK Kerkese per rishqyrtim me date 02.04.2026 , ndersa pergjigjen e kemi pranuar me date 03.04.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 18.9 i RRUOPP-së

Neni 26.4 i RRUOPP-së.

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Neni 24 RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë . 13.03.2026 është publikuar tenderi me titull “Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës

AK ka vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do të sqarojmë më poshtë:

Fillimisht ju sqarojmë se kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit është në kundërshtim me LPP-në dhe si të tilla janë kërkesa diskriminuese dhe favorizuese ju tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar “a) Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia. ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrëveshje për bashkpunim për projekt. Certifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca.”.

Kërkesa që të Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia, është kërkesë favorizuese për OE të caktuar. Kur kemi parasysh fakti se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me mirembajtjen e ndriqimit publike është shumë i qartë fakti se kërkesa mbulohet edhe nga dy elektrisitë por jo edhe me certifikata që janë favorizues dhe diskriminuese, tekniket me certifikime të tilla janë të panevojshëm në këtë aktivitet të prokurimit, po ashtu *Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia* është komplet kërkesë diskriminuese dhe favorizuese nga që vetëm *Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia e ka rrethim këte certifikim në Kosovë*, andaj kjo kërkesë duhet të largohet autoamtikisht.

AK ka vendosur këtë kërkesë e cila siç e cekëm është e panevojshme në këtë aktivitet të prokurimit e cila i përshatet një OE të caktuar, mirëpo që në këtë rast kërkesa e tillë nuk mund dhe nuk duhet të kërkohet.

Andaj kërkohet që kërkesa e lartcekur të largohet nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit.

Tek kërkesa nr.3 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kërkuar *"Një (1) teknik i elektros, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë."*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkpunim për projekt. Certifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca."*

Kërkesa e lartcekur nga ju që një teknik i elektros të jete certifikuar i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë, është kërkesë diskriminuese për OE të cilët kanë menduar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu kjo kërkesë ju pamundëson ofertimin kompanive të themeluara rishtazi të cilat e posedojnë teknike të cilën nuk i kanë certifikimet siq janë kërkuar dhe rregulluar ju një OE të caktuar duke shkelur ligjin baze të LPP dhe duke vendosur kritere diskriminuese dhe favorizuese. Kjo kërkesë është kërkesë diskriminuese sepse punën që është paraparë ta kryej tekniku të kërkuar, mund ta kryej edhe një teknikë që e ka njerëz na certifikimet tjera, si dhe në mirembajtje të ndriqimit publike nuk ka lidhje me menaxhimin e efijencës në energji, nga që nuk jeni duke planifikuar të projekton projekte të energjise por të mirembajn rrjetin e ndriqimit ekzistues, prandaj certifikimi i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së

energjisë automatiksht duhet te largohet.

Andaj kërkohet që ta ndryshohet kërkesa e lartcekur duke larguar certifikimet per person të kërkuara, sepse kështu siç është specifikuar në këtë kërkesë, shihet qartë se e njëjta është e destinuar për OE të caktuar të cilat e posedojnë nje teknike të certifikuar/trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë automatiksht duhet te largohet.

Tek kërkesa nr.4 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.
- Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projekt- ju keni kërkuar

3. *"Gjysmerimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta max. 700 kg."*

6. *Kamion me vinç me peshë të ngarkesës Minim 5 - 6 ton.*

7. *Piruner me peshë ngritëse max. 2.5 ton*

Ku disa prej ketyre kriterve jane pranuar pjeserisht nga AK duke bere "korrigjimet"
Kërkesa e perzentuar ne aneks 7 me nr. Rendore 5 *"Automjete me shportë Speciale për punë në ndriçimin public me ateste per siguri në punë"* , eshte komplet e pa qarte nga qe nuk është dhënë informacion per cfare atesti duhet te kete behet fjale , atest nga kompania e licencuar per krana nga qe paisjet nuk kan ateste per siguri ne pune,mirepo egziston fakti qe nje OE i favorizua ne kete rast e posedon nje makineri te tille e cila perveq qe eshte diskriminuese dhe favorizuaese , krijone edhe konfuzion tek OE pjesmares , kerojme te percizohet sakt per cfar lloj makinerie behete fjale .

Andaj duke u bazuar në argumentet e lartcekura kuptohet qartë se kërkesa juaj që OE të ofrojnë makineri e renditur ne aneksin 7 me nr. Rendor/7 është e panevojshme dhe e njëjta kërkesa e favorizon një OE të caktuar i cili i posedon kete lloj makinerie me ateste te paspecifikuara Duke u bazuar në këtë fakt kërkohet që kërkesa në lidhje me makinerin 7 ne dosja e tenderit konkretisht Aneksin 7 te ndryshohen ndersa per paisjen nr. Te ipen informacione te sakta, pasi që kërkesa e tillë është kërkesë diskriminuese për OE të cilët mendojnë të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është kërkesë favorizuese për OE të caktuar.

Edhe me shqetuesues eshte fakti qe Paramasat dhe Paralogaria e punuar sigurisht nga njesia kerkuese eshte diskriminuese dhe favorizuese nga qe nuk e ka percizuar sakt furnizimine me materal konkretisht :

Poz.1 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit nentoksore PPOO te permasave te

ndryshme (alumin dhe baker)

Poz.2 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit kabllit ajror SNOP te permasave te ndryshme (alumin dhe baker)

Mos saktësismi (alumin dhe baker) është shkelje e LPP , duke pas parasyshë diferencën në mes (alumin dhe baker) AK duhet ta precizojë sakt sa metra janë alumin dhe sa metra janë baker , ndryshe kërkesa e tillë është kërkesë diskriminuese dhe favorizuese , nga që AK nëse eventualisht nuk shperblhete OE i perferuari i tyre at'here OE tjere i kushtezohet që të punojë vetëm me baker dhe jo edhe me alumin , prandaj urgjentisht duhet të largohet dhe të precizohet sakt , ndrysh nuk ka logjikë që dy kabllote të jenë në një pozicion nga që kanë dalim në cmim me shumë se 3 fishe.

Poz.4 Vendosja dhe montimi i trupave ndriqes me karakteristika dhe fuqi te ndryshme ne lartesi deri ne (H = 13 m)

Duhet e saktësohet saktë fuqia e trupit ndriqes 30ëë, 50ëë, 100ëë apo 150ëë , nuk ka logjikë të lihet opsioni fuqi te ndryshme nga që në cmimi kanë dallim jashtëzakonisht të mëdha .

Këto kërkesa diskriminuese e kufizojnë konkurrencën në maksimum, ku përveç se po ju pamundëson ofertimin OE të themeluar rishtazi njëkohësisht po i diskriminon edhe operatorët ekonomik me shumë përvojë në këtë fushë të këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke marr parasyshë se paramasat janë me Çmim total të peshuar , në besojmë dhe vlersojmë se edhe paramasat dhe paralogaria është punuar për një OE të caktuar , duke mos specifikuar saktë punimet dhe duke lënë hapsiara për keqperdorim të cmimeve , që një kohësisht është në dëm të AK dhe demtimit të buxhetit .

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar

ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Pra ju me kërkesën që e cekëm më lartë dhe me përshkrimet që u cekën në këtë kërkesë për rishqyrtim, është kufizuar konkurrenca në mesin e operatorëve ekonomik dhe janë përcaktuar kritere kufizuese/favorizuese.

Me kriteret, kërkesat dhe përshkrimet që janë përcaktuar, është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 26.4 të RRUOPP sepse aty ceket qartë që *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.*

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në*

Kosovë.

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi të operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit.

Pra autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, përveç se nuk është marr parasysh kjo dispozitëjanë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit.

Operatori Ekonomik ankues thekson se të gjitha pretendimet ankimore janë adresuar fillimisht pranë Autoritetit Kontraktues përmes kërkesës për rishqyrtim të datës **01.04.2026**, në përputhje të plotë me mekanizmin e zgjidhjes preliminare të mosmarrëveshjeve të paraparë me Ligjin për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim me datë **03.04.2026**, mirëpo nga analiza e përmbajtjes së këtij vendimi rezulton se i njëjti nuk përmbush standardet ligjore të arsyetimit administrativ dhe përfaqëson një vendimarrje formale, e cila në substancë bie ndesh me dispozitat detyruese të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Fillimisht, Autoriteti Kontraktues në mënyrë kontradiktore dhe juridikisht të paqëndrueshme e ka cilësuar kërkesën për rishqyrtim si **“pjesërisht të bazuar”**, ndërsa në arsyetimin material të vendimit i trajton pretendimet ankimore si të pabazuara dhe pa nevojë për korrigjim të dokumentacionit të tenderit. Një qasje e tillë përbën mungesë serioze të koherencës juridike dhe krijon pasiguri procedurale për Operatorët Ekonomikë, duke cenuar parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **LPP Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**, pika 7, e cila përcakton qartë:

“Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.”

Nga veprimet konkrete të Autoritetit Kontraktues rezulton se i njëjti ka tentuar ta trajtojë vendimin e tij si përfundimtar dhe të mbyllë në mënyrë artificiale fazën e rishqyrtimit administrativ, duke arsyetuar në mënyrë të njëanshure mospajtimin e Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesat diskriminuese të Dosjes së Tenderit dhe duke mos garantuar në praktikë ushtrimin efektiv të së drejtës për ankim pranë OSHP-së.

Në të njëjtën linjë, është shkelur edhe pika 14 e Nenit 108/A, e cila përcakton shprehimisht se:

“Kundër refuzimeve të miratuara sipas nën-paragrafëve 1, 2 dhe 3 të paragrafit 8 dhe vendimeve të marra sipas nën-paragrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 10 të këtij neni, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.”

Kjo dispozitë garanton pa ekuivok të drejtën ligjore të ankimit dhe nuk i lë Autoritetit Kontraktues asnjë hapësirë diskrecioni për kufizimin apo reduktimin e kësaj të drejte përmes veprimeve procedurale.

Më tej, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me **LPP Neni 109 – Afatet për Dorëzimin e Ankesës**, pika 2, sipas së cilës:

“Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar afatin ligjor prej dhjetë (10) ditësh për ushtrimin e ankesës pranë OSHP-së, por ka vazhduar procedurën e prokurimit duke caktuar hapjen e tenderit më datë **10.04.2026**, duke lënë në dispozicion vetëm dy (2) ditë shtesë pas vendimit të rishqyrtimit.

Një veprim i tillë përbën kufizim faktik të së drejtës për mjet juridik efektiv, pasi e bën praktikisht të pamundur ushtrimin normal dhe të arsyeshëm të ankesës pranë OSHP-së, duke cenuar qëllimin dhe funksionin mbrojtës të dispozitave të LPP-së që garantojnë mbikëqyrje të pavarur dhe kontroll real të procedurave të prokurimit publik.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)**, Neni 24 – **Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore**, pika 24.7, e cila obligon Autoritetin Kontraktues që në rast të ndryshimit ose përmirësimit të Dosjes së Tenderit të:

- përgatisë dhe publikojë formularin B54 – **Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabimesh**, dhe

- të korrigojë versionin e fundit të Dosjes së Tenderit duke identifikuar qartë ndryshimet e bëra.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka publikuar formularin B54 dhe nuk ka bërë asnjë korrigjim real në Dosjen e Tenderit dhe në FTD. Për pasojë, edhe pse kërkesa për rishqyrtim është cilësuar formalisht si pjesërisht e bazuar, në aspektin material nuk është ndërmarrë asnjë veprim korrigjues, duke lënë të pandryshuara kërkesat kontestuese të dokumentacionit të tenderit.

Kjo situatë dëshmon se vendimi i Autoritetit Kontraktues është vetëm deklarativ dhe jo substancial, duke mos prodhuar efekt juridik real dhe duke vazhduar procedurën e prokurimit mbi bazën e një Dosjeje Tenderi që mbetet në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me parimet themelore të konkurrencës së drejtë dhe mosdiskriminimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet, provat dhe arsyetimet ligjore të paraqitura më sipër, si dhe duke marrë parasysh shkeljet evidente procedurale dhe materiale të legjislacionit për prokurimin publik, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të nxjerrë këtë:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik ankues;

OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që të bëjë ndryshimin dhe korrigjimin e kërkesave të kontestuara të Dosjes së Tenderit, sipas pretendimeve të paraqitura në këtë ankesë;

dhe pas realizimit të korrigjimeve përkatëse, të veprojë në përputhje me nenin 53 të LPP-së, duke siguruar zgjatjen e afateve dhe zhvillimin e mëtejshëm të procedurës në mënyrë të ligjshme, transparente dhe jodiskriminuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KOMUNA E PEJES

NJOFTIM PËR KONTRATË

PUNË

FURNIZIM

SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **13.03.2026**

Nr i Prokurimit	635-26-1285-2-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA E PEJES		
Adresa Postare: Hasan Prishtina, PN		
Qyteti: Pejë	Kodi postar: 30000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: MILOT GASHI		Telefoni: +383 20043405
Email: Mlot.r.gashi@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://peja.rks-gov.net/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit <i>(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)</i>		
<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit Ne Komunen e Pejës		
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë <input checked="" type="checkbox"/>		
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet): Kontrate publike kornizë me një operator <input checked="" type="checkbox"/> Kontrate publike kornizë me disa operator <input type="checkbox"/> Ekzekutimi i kontratës: Thirrje/Porosi <input checked="" type="checkbox"/> Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë <input type="checkbox"/> Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 24		
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës		
II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):		

93000000-8

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po Jo

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 103,750.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)

apo

Fillimi

Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10 % e vlerës fikse (10.375.00 Euro) të kontratës në kohzgjatje për 25 muaj % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

<p>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p>1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit</p> <p>2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.</p> <p>3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se</p> <p>a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe</p> <p>b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.</p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK) Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH –së</p> <p>Kërkesa 3 Kompania duhet të jetë e çertifikuar me këto standard ISO 9001 2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (Quality Management System – QMS) ISO 45001 2018 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OH&S) ISO 14001 2015 – Sistemi i</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje</p> <p>Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje</p> <p>Dëshmia 3 Çertifikata valide. Kriteri duhet të plotësohet nga secili antar i grupit.</p>

Menaxhimit të Mjedisit (Environmental Management System – EMS)	
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 200.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia 1 Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontrata për mirembajtje te ndriçimit publik në vlerë 150,000.00 Euro në tri vitet e fundit para dates së Publikimit te njoftimit per kontrat. Lideri duhet të ketë 60% e shumave të kerkuar.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve. Projektet e realizuara ne sektorin privat duhet te deshmojen me pagesa ne bank</p>
<p>Kërkesa 2 Një Inxhinier të Diplomuar të Elektroteknikës ose master drejtimi energjetike me minimum 5 vite përvojë pas diplomimit. Të jetë i certifikuar si auditor të energjise nga UP. Të jetë udhëheqës i punëve elektrike.</p>	<p>Dëshmia 2 Për Inxhinierin të Diplomuar të Elektroteknikës, diploma universitare, çertifikatat sipas kërkesës, kontrata e punës valide ose parakontrate për projekt, CV të nënshkruar nga vet inxhinieri dhe referenca. Vendimet për udhëheqës të nënshkruara dhe vulosura nga OE. Diploma universitare jashte shtetit te Kosoves, duhet te nostrifikohen.</p>
<p>Kërkesa 3 – Stafi Teknik OE duhet të dëshmojë se ka së paku 10 punëtorë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe 3 punëtorë të trajnuar për mbrojtje nga zjarri, të trajnuar nga një kompani e licencuar nga MPMS. Nga ky staf duhet të jenë së paku a) Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia. b) Një (1) teknik i elektros, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë.</p>	<p>Dëshmia 3 Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkpunim per projekt. Çertifikata valide sipas kërkesës, CV e nenshkruar nga vet personi dhe referenca.</p>
<p>Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.</p>	<p>Dëshmia 5 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira), të dëshmojen me kopje të librezave, deklarata doganore. (me dud doganor) Të dëshmohet se pajisjet mtorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid-Kopja e librezave të paisjeve. O.E të cilet nuk i kan paisjet e regjistruara eliminohen nga ky A.Ptë eliminohet.</p>

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar	
Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse	
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve	
Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur
<input type="checkbox"/> E kufizuar
<input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata
<input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit
IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim <i>(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)</i>
Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të riekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave <i>(procedurë konkurruese me negociata)</i>
Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme
Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar
Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata
Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:
IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik
Do të përdoret ankandi elektronik: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

--

<input checked="" type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët
	<i>ose</i>
<input type="checkbox"/>	Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

<p>IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p><i>Nëse po,</i> Njoftim paraprak: i</p> <p>Publikime tjera (<i>nëse aplikohen</i>): i i</p>
<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Dokumentet me pages</p> <p><i>Nëse po,</i> çmimi EUR Kushtet dhe metoda e pagesës:</p>
<p>IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:</p> <p><i>data 07.04.2026 koha 14:00:00 vendi Tenderët duhet te dorëzohen vetem ne mënyrë elektronike përmes Platformës Elektronike E-Prokurimi</i></p>
<p>IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:</p> <p><input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo</p> <p><i>Nëse po,</i> jep arsyetim</p>
<p>IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:</p> <p>Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p><i>Nëse po,</i> vlera e sigurisë së tenderit 2.000.00 Euro Sigurimi i tenderit duhet te dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit te tenderit do të kërkohej të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale te sigurimit te tenderit shpije ne zbatimin e nenit 99.2 te LPP-se</p> <p>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muajt</p>
<p>IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:</p> <p>Deri më: data: ditët 60 apo muajt</p>
<p>IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:</p> <p><i>data 07.04.2026 koha 14:00:00 vendi Tenderët duhet te dorëzohen vetem ne mënyrë elektronike përmes Platformës Elektronike E-Prokurimi</i></p>

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit

108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

Kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerën e parashikuar dhe në rast se vlera e mjeteve të parashikuara prej 103.750.00 Euro arrihet, atëherë automatikisht kjo Kontrate do të nderpritet, sepse tek kjo procedure nuk kemi sasi indikative +/- 30% por vetëm sasi për pozicion, prandaj edhe Kontrata ekzekutohet sipas nevojës së paraqitur nga Komuna e Pejës – Drejtorati i Shërbimeve Publike deri në vlerën e parashikuar.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL PEJE

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	633-26-1166-2-1-1
Nr i brendshëm	635/26/012/211

Sa i përket tenderit për: “Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës”.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Energy A+ SH.P.K

Veternik - Prishtine

Prishtine

049880485

Avdyl Morina

energyaplus@outlook.com

01.04.2026



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 13.03.2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 07.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për

Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 18.9 i RRUOPP-së
Neni 26.4 i RRUOPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ju me dt. 13.03.2026 keni publikuar tenderin me titull **“Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës**

Ju si AK keni vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

Fillimisht ju sqarojmë se kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit është në kundërshtim me LPP-në dhe si të tilla janë kërkesa diskriminuese dhe favorizuese ju tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar *“a) Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia. ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkpunim per projekt. Çertifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca.”.*

Kërkesa juaj që të Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia, është kërkesë favorizuese për OE të caktuar. Kur kemi parasysh fakti se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me mirembajtjen e ndriçimit publike është shumë i qartë fakti se kërkesa mbulohet edhe nga dy elektrisisite por jo edhe me certifikata që janë favorizues dhe diskriminuese, teknikat me certifikime të tilla janë të panevojshëm në këtë aktivitet të prokurimit, po ashtu *Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia* është komplet kërkesë diskriminuese dhe favorizuese nga që vetem *Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia* e ka rrethet këtë certifikim në Kosovë, andaj kjo kërkesë duhet të largohet autoamtikisht.

Ju keni vendosur këtë kërkesë e cila siç e cekëm është e panevojshme në këtë aktivitet të prokurimit e cila i përshtatet një OE të caktuar, mirëpo që në këtë rast kërkesa e tillë nuk mund dhe nuk duhet të kërkohet.

Andaj kërkojmë që kërkesa e lartcekur të largohet nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit.

Tek kërkesa nr.3 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar *“Një (1) teknik i elektros, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë.”*, ndërsa si dëshmi dokumentare keni kërkuar *“Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkpunim per projekt. Certifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca.”*.

Kërkesa e lartcekur nga ju që nje teknike i elektros të jete certifikuar i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë, është kërkesë diskriminuese për OE të cilët kanë menduar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu kjo kërkesë ju pamundëson ofertimin kompanive të themeluara rishtazi të cilat e posedojnë teknike te cilen nuk i kan certifikimet siq i keni kerkuar dhe rregulluar ju nje OE te caktuar duke shkelur ligjin baze te LPP dhe duke vendosure kritere diskrimnuese dhe favorizuese . Kjo kërkesë është kërkesë diskriminuese sepse punën që është paraparë ta kryej tekniku te kërkuar, mund ta kryej edhe një teknike qe e ka njeren na certifikimet tjera , si dhe ne mirembatje te ndriqimit publike nuk ak lidhje me menaxhmin e efiqenqes ne energji , nga qe nuk jeni duke planfikuar te projekton projekte te energjise por te mirembain rjetin e ndrqiimit ezistues , prandaj certifikimi i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë automatiksiht duhet te largohet.

Andaj kërkojmë që ta ndryshoni kërkesën e lartcekur duke e largoni certifikimet per person të kërkuara, sepse kështu siç e keni specifikuar ju këtë kërkesë, shihet qartë se e njëjta është e destinuar për OE të caktuar të cilat e posedojnë nje teknike të certifikuar/trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë automatiksiht duhet te largohet.

Tek kërkesa nr.4 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. - Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projekt- ju keni kërkuar

3. *“Gjysmerimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta max. 700 kg.”*

6. *Kamion me vinç me peshë të ngarkesës Minim 5 - 6 ton.*

7. *Piruner me peshë ngritëse max. 2.5 ton*

Caktimi i max. Si dhe min. Eshte kerkese diskrimunese dhe favorizuaese dhe si e tille autmatikist duhet te larohet.

Kërkesa juaj e perzentuar ne aneks 7 me nr. Rendore 5 *“Automjete me shportë Speciale për punë në ndriqimin public me ateste per siguri në punë”*, eshte komplet e pa qarte nga qe nuk keni dhene informacion per cfare atesti duhet te kete behet fjale , atest nga kompania e licencuar per krana nga qe paisjet nuk kan ateste per siguri ne pune,mirepo egziston fakti qe nje OE i favorizuaere ne kete rast e posedon nje makineri te tille e cila perveq qe eshte diskriminuese dhe favorizuaese , krijone edhe konfuzion tek OE pjesmares , kerojme te percizohet sakt per cfar lloj makinerie behete fjale .

Andaj duke u bazuar në argumentet e lartcekura kuptohet qartë se kërkesa juaj që OE të ofrojnë makineri e renditur ne aneksin 7 me nr. Rendore 3/6/7 është e panevojshme dhe e njëjta kërkesa e favorizon një OE të caktuar i cili i posedon kete lloj makinereie me pesha te caktur ne min. Dhe max.. Duke u bazuar në këtë fakt kërkojmë që kërkesa në lidhje me makinerin 3/6/ ne dosja e tenderit konkretisht Aneksin 7 te ndryshohen ndersa per paisjen nr. Te ipen informacione te sakta, pasi që kërkesa e tillë është kërkesë diskriminuese për OE të cilët mendojnë të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është kërkesë favorizuese për OE të caktuar.

Edhe me shqetuesues eshte fakti qe Paramasat dhe Paralogaria e punuar sigurisht nga njesia kerkuese eshte diskriminuese dhe favorizuese nga qe nuk e ka percizuar sakt furnizimine me materal konkretisht :

Poz.1 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit nentoksore PPOO te permasave te ndryshme (alumin dhe baker)

Poz.2 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit kabllit ajror SNOP te permasave te ndryshme (alumin dhe baker)

Mos saktesisimi (alumin dhe baker) eshte shkelje e LPP , duke pas parasysh diferencen ne mes (alumin dhe baker) AK duhet ta precizojte sakt sa metra jane alumin dhe sa metra jane baker , ndryshe kerkesa e tille eshte kerkese diskriminuese dhe favorizuese , nga qe AK nese eventualisht nuk shperblhete OE i perferuari i tyre at'here OE tjere i kushtezohet qe te punojve vetem me baker dhe jo edhe me aluminin , prandaj urgjentisht duhet te largohet dhe te percizohet sakt , ndrysh nuk ka logjike qe dy kabllote te jene ne nje pozicon nga qe kan dalim ne cmim me shume se 3 fishe.

Poz.4 Vendosja dhe montimi i trupave ndriques me karakteristika dhe fuqi te ndryshme ne lartesi deri ne (H = 13 m)

Duhet e saktosohet sakte fuqia e trupit ndriques 30w, 50w, 100w apo 150w , nuk ka logjike te lihet opcioni fuqi te ndryshme nga qe ne cmimi kan dallim jashtezakonisht te medha .

Ju me këto kërkesa diskriminuese po e kufizoni konkurrencën në maksimum, ku përveç se po ju pamundësoni ofertimin OE të themeluar rishtazi njëkohësisht po i diskriminoni edhe operatorët ekonomik me shumë përvojë në këtë fushë të këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke marr parasysh se paramasat jane me Çmim total te peshuar , ne besojme dhe vlersojme se edhe paramasat dhe paralogaria eshte punuar per nje OE te caktuar , duke mos specifikuar sakt punimet dhe duke lene hapsiare per keqperdorim te cmimeve , qe nje kohesisht eshte ne deme te AK dhe demtimit te buxhetit .

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Pra ju me kërkesën që e cekëm më lartë dhe me përshkrimet që u cekën në këtë kërkesë për rishqyrtim, e keni kufizuar konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik dhe keni përcaktuar kritere kufizuese/favorizuese.

Me kriteret, kërkesat dhe përshkrimet që ju i keni përcaktuar, keni vepruar edhe në kundërshtim me nenin 26.4 të RRUOPP sepse aty ceket qartë që *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishitazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.*

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshatën kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi të operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit.

Pra ju si autoritet kontraktues në vend se të keni parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, ju përveç se nuk e keni marr parasysh këtë dispozitë, ju i keni diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE
NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Pejë 03.04.2026

Në mbështetje të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 dhe, autoriteti kontraktues Komuna e Pejës (ne vazhdim AK KK PEJE . apo Autoriteti Kontraktues) ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit ekonomik **Energy A+ SH.P.K.** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit **Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës nrprok te brendeshem. 635-26-1285-2-2-1 // 635/26/012/211** dhe ne lidhje me kërkesën, nxjerr këtë:

VENDIM

I.Cilësohet si **pjeserisht e bazuara** kërkesat për ri-shqyrtim nga operatori ekonomik **Energy A+ SH.P.K.** pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit : **Mirëmbajtja dhe montimi i ndriçimit publik në Komunën e Pejës**

SQARIM

Me datën **02.04.2026** , operatoi ekonomik **Energy A+ SH.P.K.** .ka parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues (KOMUNA E PEJES) kërkesat për rishqyrtim me pretendimet si me poshtë:

PRETENDIMI 1

Ju si AK keni vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do ti sqarojmë më poshtë: Fillimisht ju sqarojmë se kërkesa e lartcekur e dosjes së tenderit është në kundërshtim me LPP-në dhe si te tilla janë kërkesa diskriminuese dhe favorizuese ju tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar "a) Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkupim per projekt. Çertifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca.". Kërkesa juaj që të Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia, është kërkesë favorizuese për OE të caktuar. Kur kemi parasysh fakti se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me mirembatjen e ndriçimit publike është shumë i qartë fakti se kërkesa mbulohet edhe nga dy elektrisisite por jo edhe me certifikata qe jane favorizues dhe diskrimnuese , tekniket me certifikme te tilla janë të panevojshëm në këtë aktivitet të prokurimit, po ashtu Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia eshte komplet kerekse diskrimnuese dhe favorizuese nga qe vetem Dy (2) elektrikistë të diplomuar, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të cilët janë të certifikuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI) kundër rënies nga lartësia e ka relaisht kete certifikim ne Kosove , andaj kjo kerkese duhet te largohet autoamtikisht Ju keni vendosur këtë kërkesë e cila siç e cekëm është e panevojshme në këtë aktivitet të prokurimit e cila i përshtatet një OE të caktuar, mirëpo që në këtë rast kërkesa e tillë nuk mund dhe nuk duhet të kërkohe.

Andaj kërkohet që kërkesa e lartcekur të largohet nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit.

Tek kërkesa nr.3 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale keni kërkuar "Një (1) teknik i elektros, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë.", ndërsa si dëshmi dokumentare keni kërkuar "Stafi Teknik Lista e stafit e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Kontrata pune aktive ose marrveshje për bashkpunim per projekt. Çertifikata valide sipas kërkesës, CV e nënshkruar nga vet personi dhe referenca."

Kërkesa e lartcekur nga ju që nje teknike i elektros të jete certifikuar i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë, është kërkesë diskriminuese për OE të cilët kanë menduar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu kjo kërkesë ju pamundëson ofertimin kompanive të themeluara rishtazi të cilat e posedojnë teknike te cilen nuk i kan certifikimet siq i keni kerkuar dhe rregulluar ju nje OE te caktuar duke shkelur ligjin baze te LPP dhe duke vendosure kriteret diskriminuese dhe favorizuese . Kjo kërkesë është kërkesë diskriminuese sepse punën që është paraparë ta kryej tekniku te kërkuar, mund ta kryej edhe një teknike qe e ka njerena certifikimet tjera , si dhe ne mirembatje te ndriqimit publike nuk ak lidhje me menaxhimin e efiqenqes ne energji , nga qe nuk jeni duke planfikuar te projekton projekte te energjise por te mirembain rrjetin e ndrqiimit ezistues , prandaj certifikimi i cili është i trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë automatiksht duhet te largohet. Andaj kërkohet që ta ndryshoni kërkesën e lartcekur duke e largoni certifikimet per person të kërkuara, sepse kështu siç e keni specifikuar ju këtë kërkesë, shihet qartë se e njëjta është e destinuar për OE të caktuar të cilat e posedojnë nje teknike të certifikuar/trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë automatiksht duhet te largohet.

PERGJIGJET 1 E AK NE PRETENDIMIN OE

Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik (OE), ju njofton si në vijim:

Fillimisht, AK sqaron se me datë 30.03.2026 është bërë korrigjimi i dosjes së tenderit, përmes të cilit janë rishikuar dhe lehtësuar kriteret e kërkuara për stafin teknik. Rrjedhimisht, pretendimi juaj se kërkohet përvojë minimale prej pesë (5) viteve nuk qëndron, pasi që kriteri aktual i publikuar kërkon përvojë minimale prej tre (3) viteve pas diplomimit.

Lidhur me kërkesën për dy (2) elektrikistë të diplomuar të trajnuar për punë në lartësi dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale (PMI), AK vlerëson se kjo kërkesë është e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e kontratës. Duke qenë se mirëmbajtja e ndriçimit publik përfshin punë në lartësi dhe ekspozim ndaj rreziqeve potenciale, kërkesat për trajnim dhe certifikim janë vendosur me qëllim të garantimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe nuk përbëjnë kërkesa diskriminuese apo favorizuese.

Po ashtu, lidhur me kërkesën për një (1) teknik të elektros të trajnuar për menaxhimin e efijencës së energjisë, AK konsideron se kjo kërkesë është e lidhur me objektin e kontratës dhe kontribuon në menaxhimin më efikas të sistemit të ndriçimit publik. Edhe në këtë rast, kriteri është lehtësuar duke ulur përvojën e kërkuar në tre (3) vite.

AK thekson se të gjitha kriteret e vendosura janë proporcionale, të arsyeshme dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke mos kufizuar konkurrencën, por duke synuar realizimin cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Duke marrë parasysh faktin se kërkesat janë korigjuar dhe lehtësuar me kohë, si dhe janë në përputhje me LPP-në, pretendimet e OE konsiderohen të pabazuara.

Prandaj, kjo pjesë e kërkesës për *rishqyrtim eshte e pa bazuar* .

PRETENDIMI 2

Tek kërkesa nr.4 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. - Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projekt- ju keni kërkuar

3."Gjysmerimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta max. 700 kg."

6. Kamion me vinç me peshë të ngarkesës Minim 5 - 6 ton.

7. Piruner me peshë ngritëse max. 2.5 ton

Caktimi i max. Si dhe min. Eshte kerkese diskriminuese dhe favorizuaese dhe si e tille autmatikist duhet te larohet.

Kërkesa juaj e perzentuar ne aneks 7 me nr. Rendore 5 "Automjete me shportë Speciale për punë në ndriçimin public me ateste per siguri në punë" , eshte komplet e pa qarte nga qe nuk keni dhene informacion per cfare atesti duhet te kete behet fjale , atest nga kompania e licencuar per krana nga qe paisjet nuk kan ateste per siguri ne pune,mirepo egziston fakti qe nje OE i favorizuaese ne kete rast e posedon nje makineri te tille e cila perveq qe eshte diskriminuese dhe favorizuaese , krijone edhe konfuzion tek OE pjesmares , kerojme te percizohet sakt per cfar lloj makinerie behete fjale . Andaj duke u bazuar në argumentet e lartcekura kuptohet qartë se kërkesa juaj që OE të

ofrojnë makineri e renditur ne aneksin 7 me nr. Rendore 3/6/7 është e panevojshme dhe e njëjta kërkesa e favorizon një OE të caktuar i cili i posedon kete lloj makinereie me pesha te caktur ne min. Dhe max.. Duke u bazuar në këtë fakt kërkojmë që kërkesa në lidhje me makinerin 3/6/ ne dosja e tenderit konkretisht Aneksin 7 te ndryshohen ndersa per paisjen nr. Te ipen informacione te sakta, pasi që kërkesa e tillë është kërkesë diskriminuese për OE të cilët mendojnë të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është kërkesë favorizuese për OE të caktuar

PERGJIGJET 2 E AK NE PRETENDIMIN OE

Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, pas shqyrtimit të pretendimeve të Operatorit Ekonomik (OE) lidhur me kërkesat për pajisje dhe mekanizim të obligueshëm sipas Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit, ju njofton si në vijim:

AK vlerëson se kërkesat për pajisje janë vendosur në funksion të realizimit të kontratës dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), duke synuar sigurimin e kapaciteteve të nevojshme teknike për kryerjen e punimeve.

Megjithatë, me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe shmangies së çdo kufizimi të panevojshëm, AK ka reflektuar pjesërisht në pretendimet tuaja dhe ka bërë korigjime si në vijim:

- Tek pozicioni nr. 3 “Gjysmë-rimorkio kompresor për thyerje të pjesëve të forta max. 700 kg”, AK sqaron se kjo kërkesë është korigjuar me datë 30.03.2026, duke larguar kufizimin maksimal dhe duke e bërë kërkesën më fleksibile dhe jo kufizuese.
- Tek pozicioni nr. 6 “Kamion me vinç me peshë të ngarkesës Minim 5 – 6 ton”, kërkesa është riformuluar në “Kamion me vinç me peshë të ngarkesës minimum 5 ton”.
- Tek pozicioni nr. 7 “Piruner me peshë ngritëse max. 2.5 ton”, kërkesa është riformuluar në “Piruner me peshë ngritëse minimum 2.5 ton”.

Sa i përket pretendimit për paqartësi lidhur me “automjetin me shportë speciale për punë në ndriçimin publik me ateste për siguri në punë”, AK sqaron se kërkesa ka për qëllim sigurimin që pajisjet të jenë të certifikuara dhe të sigurt për përdorim, në përputhje me standardet përkatëse të sigurisë në punë dhe legjislacionin në fuqi. Kjo kërkesë nuk është favorizuese për ndonjë operator të caktuar, por është vendosur për të garantuar sigurinë gjatë realizimit të kontratës.

Gjithashtu, AK thekson se, në përputhje me LPP-në, operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë disponueshmërinë e pajisjeve edhe përmes marrëveshjeve për qira apo forma të tjera bashkëpunimi, andaj këto kërkesa nuk kufizojnë konkurrencën.

Duke marrë parasysh korigjimet e bëra, AK konsideron se kërkesat për pajisje janë proporcionale, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese.

Prandaj, kjo pjesë e kërkesës për rishqyrtim *aprovohet pjesërisht*.

PRETENDIMI 3

Edhe me shqetuesues është fakti që Paramasat dhe Paralogaria e punuar sigurisht nga njesia kerkuese është diskriminuese dhe favorizuese nga që nuk e ka percizuar sakt furnizimin me material konkretisht : Poz.1 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit nentoksore PPOO te permasave te ndryshme (alumin dhe baker) Poz.2 Rregullimi, shtrirja dhe konektimi I kabllit kabllit ajror SNOF te permasave te ndryshme (alumin dhe baker) Mos saktësisht (alumin dhe baker) është shkelje e LPP , duke pas parasysh diferencën në mes (alumin dhe baker) AK duhet ta precizojë sakt sa metra janë alumin dhe sa metra janë baker , ndryshe kërkesa e tillë është kërkesë diskriminuese dhe favorizuese , nga që AK nëse eventualisht nuk shperblhete OE i perferuari i tyre at'here OE tjere i kushtezohet që të punojnë vetëm me baker dhe jo edhe me alumin , prandaj urgjentisht duhet të largohet dhe të precizohet sakt , ndrysh nuk ka logjike që dy kabllote të jenë në një pozicion nga që kanë dalim në cmim me shumë se 3 fise. Poz.4 Vendosija dhe montimi i trupave ndriçues me karakteristika dhe fuqi të ndryshme në lartësi deri në (H = 13 m) Duhet të saktësohet saktë fuqia e trupit ndriçues 30w, 50w, 100w apo 150w , nuk ka logjike të lihet opsioni fuqi të ndryshme nga që në cmimi kanë dallim jashtëzakonisht të mëdha .

PERGJIGJET 3 E AK NE PRETENDIMIN OE

Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, pas shqyrtimit të pretendimeve të Operatorit Ekonomik (OE) lidhur me Paramasën dhe Paralogarinë, ju njofton si në vijim:

AK vlerëson se Paramasa dhe Paralogaria janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me pozicionet 1 dhe 2, ku janë përfshirë kablo nëntokësore dhe ajrore të përbëra nga alumin dhe bakër, AK sqaron se përfshirja e të dy materialeve në të njëjtin pozicion është bërë duke marrë parasysh natyrën e kontratës për mirëmbajtje, ku nevojat në terren nuk mund të parashikohen në mënyrë fikse për secilin material veç e veç. Kjo qasje është standarde në kontratat e mirëmbajtjes dhe nuk përbën shkelje të LPP-së.

Operatorët ekonomikë, në përgatitjen e ofertave të tyre, duhet të bazohen në çmime mesatare të tregut dhe përvojën profesionale për realizimin e punimeve të ngjashme. Kjo formë e përlllogaritjes nuk favorizon asnjë operator ekonomik të caktuar dhe nuk kufizon konkurrencën.

Lidhur me pretendimin se AK mund të detyrojë OE për përdorimin e një materiali të caktuar (p.sh. vetëm bakër), AK sqaron se realizimi i punimeve do të bëhet gjithmonë në përputhje me kërkesat teknike, projektet ekzistuese dhe standardet përkatëse, dhe nuk do të ketë ndryshime arbitrare që do të cenonin operatorin ekonomik fitues.

Sa i përket pozicionit 4, lidhur me vendosjen dhe montimin e trupave ndriçues me fuqi të ndryshme, AK sqaron se kjo është bërë për shkak të natyrës së projektit, i cili përfshin ndërhyrje në lokacione të ndryshme me kërkesa të ndryshme teknike. Specifikimi i një game të fuqive është në funksion të fleksibilitetit gjatë realizimit të kontratës dhe nuk përbën kriter diskriminues.

AK thekson se të gjitha pozicionet në Paramasë dhe Paralogari janë të hartuara në mënyrë profesionale, proporcionale dhe në funksion të realizimit të kontratës, duke mos favorizuar asnjë operator ekonomik dhe duke siguruar trajtim të barabartë për të gjithë.

Duke u bazuar në sa më sipër, pretendimet e OE lidhur me Paramasën dhe Paralogarinë konsiderohen të pabazuara.

Prandaj, kjo pjesë e kërkesës për *rishqyrtim është e pa bazuar*.

Po ashtu, AK njofton se pas korrigjimeve të bëra, në përputhje me LPP-në, është bërë edhe shtyrja e afatit për hapjen e ofertave. *Hapja e ofertave është shtyrë deri më datë 10.04.2026 në ora 13:30, përmes Formularit standard B54*, me qëllim që t'u mundësohet operatorëve ekonomikë kohë e mjaftueshme për përgatitjen e ofertave të tyre.

Me respekt

MILOT Gashi
Menaxher i Prokurimit.